

**VENDIM**  
**Nr. 567, datë 3.9.2014**

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 845, DATË 27.9.2013, TË KËSHILLIT TË**  
**MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E FUSHËS SË PËRGJEGJËSISË SHTETËRORE**  
**TË MINISTRISË SË MIRËQENIES SOCIALE DHE RINISË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 5, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Në kreun III, të vendimit nr. 845, datë 27.9.2013, të Këshillit të Ministrave, pas pikës 13 shtohet pika 14, me këtë përmbajtje:

“14. Marrjen e masave dhe ndjekjen e çështjeve që kanë të bëjnë me integrimin në jetën e shoqërisë shqiptare të ish-të përndjekurve politikë nga regjimi komunist.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Edi Rama**